



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 13730/4 Prot

Lezhë, më 06.08.2025

Relacion për Projekt Vendimin mbi miratimin e Planit Vendor Social 2026-2028

Projekt vendimi është hartuar në mbështetje të Ligjit 139, Neni 54 pika K” Këshilli Bashkiak miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 e Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar.

Objekti i këtij Projekt-Vendimi është miratimi i Planit Vendor Social 2026-2028 të Bashkisë Lezhë, si një dokument strategjik vendor ku synon të analizojë gjendjen ekzistuese të shërbimeve sociale në territor, të identifikojë boshllëqet dhe sfidat, si dhe të përkufizojë objektiva të qarta për periudhën trevjeçare 2026-2028. Dokumenti është hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar, strategjitë përkatëse sektoriale dhe standardet minimale të shërbimeve, duke integruar gjithashtu kontributet e komunitetit dhe aktorëve të shumtë lokalë.

Përmes këtij Plani, Bashkia Lezhë synon të fuqizojë sistemin komunitar të mbrojtjes dhe kujdesit social, të përmirësojë aksesin, cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve, si dhe të rrisë kapacitetet institucionale për të përmbushur me përgjegjësi misionin e saj ndaj qytetarëve më në nevojë. Hartimi i këtij plani është zhvilluar në periudhën Shkurt-Korrik 2025, përmes një procesi konsultativ dhe të bazuar në evidencë, nën koordinimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale. Procesi i hartimit të Planit Social për Bashkinë Lezhë është zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, e mbështetur në të dhëna, konsultim me aktorët lokalë dhe orientim drejt standardeve kombëtare.

Kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i Lezhës i Planit Vendor Social 2026-2028 .

Miratimi i këtij dokumenti do t'i japë bashkisë Lezhë një bazë të fortë për veprime konkrete, një hartë rruge ligjërish të vlefshme e cila ndihmon të koordinojë aktorët dhe të përmirësojë jetën e qytetarëve.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

K R Y E T A R I

Pjerin NDREU

NË MUNGESË DHE ME URDHER

ZV.KRYETAR

Brikena VUKSANI

